

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632-26-3785-1-1-1 632-26-022-111**

Sa i përket tenderit për **"Furnizim me dru dhe pelet"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GRESA COMMERC NTP - 810584327

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

PIRAN

(Adresa)

Prizren

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349611761

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Sahit Bajrami

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

n timer1@hotmail.com

(Adresa elektronike)

07.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me dru dhe pelet”, me numër të prokurimit 632-26-3785-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-26-022-111.

Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit janë publikuar më 18.08.2026.

Vlera e parashikuar e aktivitetit është 200,000.00 EUR.

Sipas Dosjes së Tenderit, aktiviteti është strukturuar si një lot i vetëm, duke përfshirë furnizimin me dru zjarri dhe furnizimin me pelet.

Sipas sasive indikative të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, aktiviteti përfshin rreth 560 ton pelet dhe 192 m³ dru zjarri.

Në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar ndër të tjera: 1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton.

Mosplotësimi i kërkesave minimale rezulton me eliminimin e tenderuesit.

OE GRESA COMMERC N.T.P., si palë e interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet, ka konsideruar se mënyra e strukturimit të aktivitetit, kriteri specifik i mjeteve transportuese dhe vlera e parashikuar e kontratës nuk janë në përputhje të plotë me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe planifikimit real të prokurimit.

Për këtë arsye, më 25.08.2026, OE GRESA COMMERC ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues.

Me Vendimin e datës 28.08.2026, Autoriteti Kontraktues e ka REFUZUAR si të pabazuar Kërkesën për Rishqyrtim, ka VËRTETUAR Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë dhe ka vendosur të vazhdojë aktivitetin e prokurimit.
Kjo ankesë paraqitet kundër këtij Vendimi dhe kundër mbajtjes në fuqi të kushteve të kontestuara.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Po. OE GRESA COMMERC N.T.P. ka parashtruar më 25.08.2026 Kërkesë për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës.

- Mosndarja e aktivitetit në lote dhe kufizimi i konkurrencës;
- Kriteri joproporcional dhe kufizues për mjetet transportuese – 1 kamion maksimum 7 ton dhe 2 kamionë maksimum 5 ton;
- Vlera e parashikuar prej 200,000.00 EUR nuk rezulton e arsyeshme dhe reale në raport me sasi të dhe çmimet aktuale të tregut.

Autoriteti Kontraktues, me Vendimin e datës 28.08.2026, i ka refuzuar të tri pretendimet dhe ka vendosur të vazhdojë aktivitetin pa korrigjuar Dosjen e Tenderit.

Pretendimet e paraqitura në këtë ankesë janë të njëjta me pretendimet e ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim. Në këtë fazë ato vetëm shtjellohen më tej në raport me arsyetimin e Vendimit të AK-së dhe mbështeten me prova shtesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 6 i LPP-së – ekonomiciteti dhe efikasiteti në përdorimin e fondeve publike;
- Neni 7 i LPP-së – trajtimi i barabartë, mosdiskriminimi, transparenca dhe siguri i konkurrencës sa më të gjerë;
- Neni 16.1 i LPP-së – vlera e parashikuar e kontratës për furnizim duhet të pasqyrojë çmimin përfundimtar të parashikuar që do të paguajë AK dhe elementet e parashikueshme të çmimit;
- Neni 27 i LPP-së – përgatitja dhe përmbajtja e Dosjes së Tenderit;
- Neni 51.3 i LPP-së – kriteret e përzgjedhjes, dokumentet dhe informatat e kërkuara duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës;
- Neni 69 i LPP-së – kapaciteti teknik dhe profesional dhe dëshmitë për aftësinë e operatorëve ekonomikë;
- Neni 105 i LPP-së – kompetencat e OSHP-së për të hetuar faktet, për të kërkuar dokumente dhe për të verifikuar pretendimet;
- Neni 112 i LPP-së – efekti pezullues i ankesës;
- Neni 13 i Rregullores Nr. 001/2022 – veçanërisht dispozitat sipas të cilave vlera e parashikuar duhet të jetë e arsyeshme dhe reale dhe AK duhet të marrë parasysh çmimet e tregut, kontratat paraprake dhe analizën e kostos;
- Neni 13.2 i Rregullores Nr. 001/2022 – ndarja e kontratave me mallra homogjene ose heterogjene në lote, veçanërisht për të inkurajuar NVM-të dhe për të siguruar konkurrencë më të gjerë përmes operatorëve të specializuar;
- Neni 17.17 i Rregullores Nr. 001/2022 – Dosja e Tenderit duhet të përgatitet në mënyrë që të mos kufizojë konkurrencën dhe të mos diskriminojë ose favorizojë operatorë ekonomikë;
- Nenet 62 dhe 63 të Rregullores Nr. 001/2022 – shqyrtimi dhe arsyetimi i vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim;
- Neni 64 i Rregullores Nr. 001/2022 – paraqitja e ankesës në OSHP;
- Neni 66.1 i Rregullores Nr. 001/2022 – pezullimi automatik i aktivitetit të prokurimit pas dorëzimit të ankesës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa parashtrohet kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 28.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE GRESA COMMERC. Pretendimet e mëposhtme janë të njëjta me ato të ngritura në Kërkesën për Rishqyrtim. Në këtë fazë paraqiten edhe kundërgargumentet ndaj arsyetimit me të cilin AK i ka refuzuar ato.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1 – MOSNDARJA E AKTIVITETIT NË LOTE DHE KUFIZIMI I KONKURENCËS

Autoriteti Kontraktues ka vendosur që furnizimi me dru zjarri dhe furnizimi me pelet të realizohen në kuadër të një loti të vetëm.

OE ankues nuk pretendon se çdo kontratë që përmban kategori të ndryshme mallrash duhet detyrimisht të ndahet në lote. Pretendimi është se diskrecioni i Autoritetit Kontraktues për ta mbajtur aktivitetin në një lot nuk është absolut dhe duhet të ushtrohet në pajtim me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit, ekonomicitetit dhe mosdiskriminimit.

Druri i zjarrit dhe peleti janë dy kategori të dallueshme të mallrave. Ato kanë prodhues të ndryshëm, furnitorë të ndryshëm, burime të ndryshme furnizimi, karakteristika të ndryshme teknike, procese të ndryshme prodhimi, mënyra të ndryshme magazinimi dhe treg/strukturë të ndryshme të operatorëve ekonomikë.

Në treg ekzistojnë operatorë ekonomikë të specializuar në furnizimin me dru zjarri dhe operatorë të specializuar në furnizimin ose prodhimin e peletit.

Duke i bashkuar këto dy kategori në një lot, një operator ekonomik që ka kapacitet të plotë për realizimin e furnizimit me dru, por nuk merret me pelet, nuk mund të ofertojë individualisht. E njëjta situatë vlen edhe për një furnizues ose prodhues të peletit që nuk merret me tregtimin e druve.

Arsyetimi i AK-së

AK e arsyeton një kontratë të vetme me një pikë të vetme përgjegjësie kontraktuale, koordinim më të unifikuar, monitorim më efikas, reagim më të shpejtë dhe menaxhim më ekonomik.

OE nuk konteston se këto mund të përbëjnë përfitime administrative. Mirëpo këto janë arsye të përgjithshme që mund të përdoren praktikisht për çdo aktivitet të ndarë në lote. Vendimi nuk përmban analizë konkrete që balancon përfitimin administrativ të pretenduar me efektin kufizues mbi konkurrencën.

Pyetja juridike nuk është nëse AK-së i lejohet të përdorë një lot të vetëm. Pyetja është: A ka dëshmuar AK në rrethanat konkrete se përfitimi nga një kontratë e vetme është proporcional me kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve të specializuar?

- analizë të numrit të operatorëve potencialë;
- analizë të ndikimit të mosndarjes në konkurrencë;
- krahasim të mundshëm të çmimeve në rast ndarjeje;
- analizë të kostos administrative të dy loteve;
- ndonjë pengesë teknike që e bën të pamundur ndarjen.

Argumenti i AK-së se operatorët mund të formojnë grup operatorësh ekonomikë ose të përdorin nënkontraktim nuk e eliminon efektin kufizues. Mundësia e formimit të grupit është një e drejtë e OE-së dhe nuk duhet të shndërrohet në domosdoshmëri vetëm që një operator i specializuar të mund të marrë pjesë në procedurë.

Zgjidhja e mundshme

Aktiviteti mund të strukturohet: LOT 1 – Furnizim me dru zjarri; LOT 2 – Furnizim me pelet, duke lejuar që OE të ofertojë për njërin ose për të dy lotet.

Nëse i njëjti operator paraqet ofertën më të favorshme në të dy lotet, ai mund t'i fitojë të dy, prandaj ndarja nuk nënkupton domosdoshmërisht që AK do të ketë dy operatorë të ndryshëm. Nëse operatorë të ndryshëm janë më konkurrues për secilin produkt, AK përfiton çmimin më të favorshëm për secilën kategori.

Përfundim për Pretendimin nr. 1: OE kërkon që aktiviteti të ndahet në LOT 1 – Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 – Furnizim me pelet dhe kriteret ekonomike, financiare, teknike dhe profesionale të përshtaten proporcionalisht për secilin lot. Subsidiarisht, nëse OSHP

vlërëson se ndarja në lote nuk është juridikisht e detyrueshme, kërkohet që AK të obligohet të kryejë dhe dokumentojë një analizë konkrete të proporcionalitetit dhe ndikimit në konkurrencë para vazhdimit të procedurës.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – KRITERI JOPROPORCIONAL PËR MJETET TRANSPORTUESE

Dosja e Tenderit kërkon: 1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton.

OE nuk konteston të drejtën e AK-së për të kërkuar që operatori ekonomik të ketë mjete të mjaftueshme për realizimin e kontratës. Nuk kontestohet as mundësia që AK të përcaktojë një numër minimal mjetesh, nëse ky numër është objektivisht i nevojshëm. Ajo që kontestohet është imponimi i kufijve maksimalë prej 5 dhe 7 tonësh dhe konfigurimi i ngurtë i flotës pa analizë teknike që provon pse automjetet me kapacitet më të madh janë të papërshtatshme.

Arsyetimi i AK-së

Në Vendimin e datës 28.08.2026, AK e arsyeton kriterin me afatin prej 3 ditësh për furnizim, numrin e institucioneve, lokacionet e ndryshme, urdhërblertjet e mundshme të njëkohshme, vazhdimësinë në rast defekti të ndonjë automjeti dhe nevojën për së paku tri mjete.

Këto argumente mund të shpjegojnë numrin e automjeteve. Por nuk shpjegojnë pse dy automjete duhet të jenë MAKSIMUM 5 ton dhe një automjet MAKSIMUM 7 ton.

Shembulli	Konfigurimi	Kapaciteti total	Rezultati sipas kriterit
OE A	7 t + 5 t + 5 t	17 t	Kalon
OE B	8 t + 6 t + 6 t	20 t	Mund të eliminohet
Efekti	OE B ka kapacitet superior	+3 t	Kriteri nuk mat kapacitetin real

Ky shembull dëshmon se kriteri nuk mat aftësinë reale për realizimin e kontratës. Ai mat vetëm përputhjen me një konfigurim numerik të paracaktuar. Kjo është në kundërshtim me Nenin 51.3 të LPP-së, sipas të cilit kriteret dhe dëshmitë e kërkuara duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Mungesa e bazës teknike

Nëse AK pretendon se kamionët mbi 5 ose 7 ton nuk mund të hyjnë në lokacione të caktuara, kjo duhet të provohet konkretisht. Vendimi nuk identifikon:

- asnjë shkollë konkrete;
- asnjë rrugë konkrete;
- asnjë kufizim tonazhi;
- asnjë oborr ose hyrje me kufizim fizik;
- asnjë urë;
- asnjë dimension;
- asnjë raport teknik;
- asnjë analizë profesionale.

Për këtë arsye kërkohet që OSHP, në kuadër të kompetencave të veta sipas Nenit 105 të LPP-së, t'i kërkojë AK-së dokumentacionin mbi të cilin është përcaktuar kufiri “maksimum 5 ton / maksimum 7 ton”. Nëse një analizë e tillë nuk ka ekzistuar para publikimit të Dosjes së Tenderit, kriteri nuk duhet të arsyetohet retroaktivisht pas kundërshtimit të OE-së.

Përfundim për Pretendimin nr. 2: Kriteri duhet të largohet në formulimin aktual dhe të zëvendësohet me një kërkesë funksionale, për shembull: “Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon, përmes pronësisë, qirasë ose një marrëveshjeje tjetër të ligjshme, mjete transportuese të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e furnizimit brenda afatit kontraktual.” Nëse AK kërkon numër ose kapacitet të caktuar minimal/maksimal, ai duhet të mbështetet me analizë objektive dhe teknike.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3 – VLERA E PARASHIKUAR PREJ 200,000.00 EUR NUK REZULTON E ARSYESHME DHE REALE

Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar vlerën e parashikuar të aktivitetit në 200,000.00 EUR. Sipas sasive indikative të Dosjes së Tenderit, aktiviteti përfshin rreth 560 ton pelet dhe 192 m³ dru zjarri.

Sipas Nenit 13 të Rregullores Nr. 001/2022, paralogaritja e vlerës së kontratës duhet të jetë e arsyeshme dhe reale, ndërsa AK duhet të marrë parasysh çmimet e tregut, kontratat paraprake dhe analizën e kostos. Gjithashtu, sipas Nenit 16.1 të LPP-së, vlera e parashikuar e kontratës për furnizim duhet të pasqyrojë çmimin përfundimtar të parashikuar që do të paguajë AK dhe elementet relevante të çmimit.

Dy prova konkrete të tregut

Furnitori	Data	Produkti	Sasia	Çmimi pa TVSH	Çmimi me TVSH
GNTC Group SH.A.	15.07.2026	Pelet druri Class A2	1,000 kg	338.98 € afërsisht	400.00 €/ton
Alfa Globe SHPK	15.07.2026	Pelet druri për ngrohje	52 ton	330.508 €/ton	390.00 €/ton

Oferta e Alfa Globe është veçanërisht relevante sepse është ofertë për 52 ton, pra një furnizim komercial me shumicë dhe jo çmim pakice. Të dy ofertat janë të datës 15.07.2026, vetëm rreth një muaj para publikimit të aktivitetit më 18.08.2026.

Kalkulimi me çmimin më të ulët të dokumentuar

Elementi	Formula	Rezultati
Pelet - me TVSH	560 ton × 390.00 €	218,400.00 €
Tejkalimi vetëm nga peleti	218,400.00 € - 200,000.00 €	18,400.00 €
Pelet - pa TVSH	560 ton × 330.508 €	185,084.48 €
Mbetja nga 200,000 €	200,000.00 € - 185,084.48 €	14,915.52 € për 192 m ³ dru + kostot tjera

Pika vendimtare: edhe duke përdorur çmimin më të ulët të dokumentuar, vetëm 560 ton pelet japin 218,400.00 EUR me TVSH, pra 18,400.00 EUR mbi tërë vlerën e parashikuar të aktivitetit, pa përfshirë fare 192 m³ dru zjarri.

Përgjigjja ndaj arsyetimit të AK-së

Arsyetimi i AK-së	Kundërargumenti / prova
“Nuk janë identifikuar furnitorët.”	GNTC Group SH.A. dhe Alfa Globe SHPK identifikohen qartë.
“Nuk është dëshmuar data e çmimeve.”	Të dy ofertat janë të datës 15.07.2026.
“Nuk është dëshmuar furnizimi me shumicë.”	Oferta Alfa Globe është për 52 ton, vlerë totale 20,280.00 EUR.
“Nuk është dëshmuar TVSH-ja.”	Të dy dokumentet paraqesin TVSH 18%.
“Sasitë janë indikative ±30%.”	Devijimi i lejuar nuk e zëvendëson detyrimin që paralogaritja fillestare të jetë e arsyeshme dhe reale.

Sa i përket transportit dhe kushteve DDP, OE nuk pretendon më shumë se çfarë provojnë dokumentet. Ofertat nuk deklarojnë shprehimisht se çmimi përfshin dorëzimin DDP në secilën shkollë të Gjakovës. Mirëpo kjo nuk e dobëson pretendimin. Nëse transporti dhe shpërndarja nuk janë të përfshira, ato përbëjnë kosto shtesë dhe nuk mund ta zvogëlojnë vlerën e furnizimit.

Sqarim procedural lidhur me këto prova: Dy ofertat e tregut të bashkëngjitura nuk përbëjnë pretendim të ri ankimor. Ato janë prova shtesë në mbështetje të Pretendimit Ankimor nr. 3, i cili është ngritur shprehimisht në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 25.08.2026.

Kërkesë për verifikim nga OSHP

AK në Vendimin e vet deklaron se ka “rishqyrtuar bazën” e përcaktimit të vlerës së parashikuar. Mirëpo nuk paraqet metodologjinë konkrete. Për këtë arsye kërkohet që OSHP t'i kërkojë AK-së:

- çmimin njësi që ka përdorur për 1 ton pelet;

- çmimin njësi për 1 m³ dru;
- burimet konkrete të tregut;
- datën e hulumtimit të tregut;
- kontratat paraprake të përdorura për krahasim;
- analizën e kostos;
- transportin dhe shpërndarjen;
- dokumentin e paralogaritjes mbi të cilin është prodhuar vlera 200,000.00 EUR.

Përfundim për Pretendimin nr. 3: Ekziston dyshim objektiv dhe i dokumentuar se vlera prej 200,000.00 EUR nuk pasqyron realisht sasi të dhe çmimet aktuale të tregut. Për këtë arsye kërkohet rishqyrtimi i paralogaritjes dhe, nëse nga verifikimi rezulton se vlera nuk është reale, korrigjimi i vlerës së parashikuar dhe planifikimit financiar.

Më posht gjeni ofertat e peletit nga dy furnitor te ndryshem:



"Alfa Globe"Shpk

Nr. Unik: 811410282

Nr. Tvsh: 330447153

Rruga M 2, Veternik-Prishtinë, Kosovë.

Subjekti:

Nr. unik/fiskal:

Nr. biznes/tvsh:

Kontakti:

Adresa:

- KS

Ofertë



15-029-001-26

Njësia Org.		Data e Porosisë		Data e liferimit		Referenca		Referenti i juaj		Kushtet
Depoja Kryesore		15.07.2026		25.07.2026						NET 10
Nr	Shifra	Përshkrimi	Sasia	Njësia	Çmimi pa Tvsh	Rabati (%)	Tvsh %	Çmimi me rabat	Çmimi shitës	Vlera shitëse
1	122	Pelet druri, për nxemje qendrore, Paketimi 15/1 Kg	52.000	T	330.508	0.00	18.00	330.508	390.000	20.280.00

Pas kalimit të afatit të pagesës aplikohen ndeshkimet

Vlera pa rabat:		17,186.44	EUR
Rabati:	0.00%	0.00	EUR
Rabati shtesë:	0.00%	0.00	EUR
Vlera pa tvsh:		17,186.44	EUR
Tvsh:	18.00%	3,093.56	EUR
Vlera për pagesë:		20,280.00	EUR



Dërgoi:

Kontrolloi:

Pranoi:



Rruga M 2, Veternik-Prishtinë
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 44 192 422

E-mail: info@alfaglobe-ks.com

Vërejtje: Kjo faturë është e vlefshme pa nënshkrim edhe vullë

© Copyright ALBTRIX 2007 - 2026

Nr. Unik: 811410282

Nr. Fiskal: 811410282

Nr. Tvsh: 330447153

PCB : 11 89 0083530001 03

Swift Code: MBK0XKPRXXX

Iban: XK051189008353000103

TEB : 20 22 0001811641 59

RBKO : 15 01 0900043976 65

Page 1/1

"GNTC Group" SH.A.

GDS 1 - PRISHTINE

NUI: 810443854 NRTVSH: 330088395

Rr. Prishtinë-Gjilan, nr.34, Veturik, 10000 Prishtinë

049777721,

gds1pr m@gds-ks.com / www.75mall.com

Ofertë

Nr Doc:

1060 / 2026

Data

15.07.2026, Afati i pagesës: 16/07/2026

Blerësi

NUI

Adresa

Tel.

Nr	Shifra	Emertimi Numri Serik	Njesia	Sasia	Çmimi	Zbritje (%)	Ekstra Zbritje	Çmimi Pa Tresh	Vlera Pa Tresh	Tresh (%)	Vlera Me Tresh
1	A2P	PELET DRURI CLASS A2 12.5 KG	KG	1,000.00	0.440	0.00	9.09	0.37	338.9800	18.00	400.00

Vërejtje:

Vlera pa Zbritje

440.00€

Zbritje

0.00€

Super Zbritje

40.00€

Total me Zbritje

400.00€

Norma

TVSH

Vlera e tatueshme

18.00 %

61.02

338.99

Per Pagesë:

400.00



PCB: 1110011122000197 NLB: 1700200100088831 RBKO: 1501001000880076 TEB: 2011000000129632

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I VENDIMIT TË AK-së

Vendimi i AK-së nuk i përgjigjet plotësisht thelbit të pretendimeve të OE-së. Në Pretendimin nr. 2, AK arsyeton nevojën për disa mjete transportuese, por nuk arsyeton kufirin maksimal prej 5 dhe 7 tonësh. Në Pretendimin nr. 1, AK paraqet përfitime të përgjithshme administrative nga një kontratë e vetme, por nuk analizon efektin konkret të mosndarjes në konkurrencë. Në Pretendimin nr. 3, AK deklaron se ka rishqyrtuar bazën e vlerës së parashikuar, por nuk bën të verifikueshme metodologjinë dhe dokumentet mbi të cilat është arritur në shumën 200,000.00 EUR.

Kjo pjesë nuk paraqitet si pretendim i ri, por si argument shtesë në mbështetje të tri pretendimeve të ngritura që në fazën e Kërkesës për Rishqyrtim.

EFEKTI PEZULLUES I ANKESËS

Me dorëzimin e kësaj ankese, kërkohet zbatimi i Nenit 112 të LPP-së dhe Nenit 66.1 të Rregullores Nr. 001/2022, lidhur me pezullimin e aktivitetit të prokurimit, për aq kohë sa nuk merret vendim tjetër nga organi kompetent sipas ligjit.

KËRKESA / PETITUMI DREJTUAR OSHP-së

Duke u bazuar në faktet, argumentet, provat dhe dispozitat e sipërpërmendura, OE GRESA COMMERC N.T.P. i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit që të nxjerrë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE GRESA COMMERC N.T.P.;
2. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës, i datës 28.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim;
3. **OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues që ta korrigjojë strukturimin e aktivitetit duke e ndarë në LOT 1 – Furnizim me dru zjarri dhe LOT 2 – Furnizim me pelet, me kriteret të veçanta dhe proporcionale për secilin lot;
4. **SUBSIDIARISHT**, nëse OSHP vlerëson se ndarja në lote nuk është juridikisht e detyrueshme, **OBLIGOHET** AK të kryejë dhe dokumentojë analizë konkrete të proporcionalitetit dhe ndikimit në konkurrencë para vazhdimit të procedurës;
5. **ANULOHET/NDRYSHOHET** kriteri “1 kamion me peshë ngarkuese maksimum 7 ton dhe 2 kamionë me peshë ngarkuese maksimum 5 ton”, në pjesën ku vendosen kufij maksimalë pa arsyetim teknik;
6. **OBLIGOHET** AK që kriterin për transport ta riformulojë në mënyrë funksionale, duke kërkuar mjete të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e furnizimit brenda afatit kontraktual, pa eliminuar automjete ekuivalente ose me kapacitet superior;
7. **OBLIGOHET** AK t'i paraqesë OSHP-së dokumentacionin dhe metodologjinë mbi të cilën është përcaktuar vlera e parashikuar prej 200,000.00 EUR, përfshirë çmimet njësi, burimet e tregut, kontratat paraprake dhe analizën e kostos;
8. **NËSE** nga verifikimi rezulton se vlera prej 200,000.00 EUR nuk pasqyron realisht çmimin e furnizimit, **OBLIGOHET** AK ta korrigjojë vlerën e parashikuar dhe planifikimin financiar;
9. **OBLIGOHET** AK, pas korrigjimit të Dosjes së Tenderit, të publikojë korrigjimet përkatëse dhe të caktojë afat të ri/adekuat për dorëzimin e ofertave;
10. **KONSTATOHET** efekti pezullues i ankesës sipas Nenit 112 të LPP-së dhe Nenit 66.1 të Rregullores, për aq kohë sa nuk merret vendim tjetër nga organi kompetent;
11. **KTHEHET** tarifa e ankesës OE GRESA COMMERC N.T.P. nëse ankesa aprovet si e bazuar, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

OE GRESA COMMERC N.T.P. ka interes të drejtpërdrejtë dhe real për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit. Veprimet dhe kriteret e kontestuara e kërcënojnë OE-në me dëm përmes:

- kufizimit të mundësisë për pjesëmarrje në kushte të barabarta;
- pamundësisë për ofertim vetëm për kategorinë e furnizimit për të cilën OE ka kapacitet;
- mundësisë së eliminimit për një konfigurim specifik të mjeteve që nuk lidhet domosdoshmërisht me kapacitetin real;
- humbjes së mundësisë për fitimin e kontratës;
- humbjes së të ardhurave dhe fitimit të pritshëm;
- shpenzimeve për përgatitjen e ofertës;
- shpenzimeve për ushtrimin e mjeteve juridike.

Dëmi material nuk mund të përcaktohet ende me saktësi monetare, pasi aktiviteti ndodhet para fazës së përfundimit dhe kontraktimit. OE rezervon të gjitha të drejtat ligjore lidhur me dëmin eventual të shkaktuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*